



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 477/ 9 prot.,

Datë 05 .03.2026

V E N D I M

Nr.352 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05 .03.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Mbrotjtja dhe shpëtimi nga zjarri” SH.P.K, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-67760-11-05-2025, me objekt: “Verifikimi dhe testimi i sistemeve të zjarrit në impjantet përgjatë gazsjellësit TAP”, me fond limit 4.328.529 (kater milion e treqind e njezete e tete mije e pesëqind e njezete e nente) lekë pa tvsh (pa TVSH), zhvilluar me datë 30-01-2026 nga autoriteti kontraktor, Albanian Gas Service Company Sh.a.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Fire” SHPK , në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-67760-11-05-2025, me objekt: “Verifikimi dhe testimi i sistemeve të zjarrit në impjantet përgjatë gazsjellësit TAP”, me fond limit 4.328.529 (kater milion e treqind e njezete e tete mije e pesëqind e njezetë e nëntë) lekë pa tvsh (pa TVSH), zhvilluar me datë 30-01-2026 nga autoriteti kontraktor, Albanian Gas Service Company Sh.a.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Mbrotjtja dhe shpëtimi nga zjarri” SHPK me NIPT L62102007V, Adresa: *Rruga “Artan Lenja”, Hyrja Nr.1, Zone Kadastrale Nr.8210, Nr.Pasurie 1/301-N3.*

Autoriteti Kontraktor: Albanian Gas Service Company Sh.a, Adresa: Rruga "Kosovarëve", pallati: NderPro, Tiranë.

Subjekte të Interesuara: Operator ekonomik "FIRE" sh.p.k, me NIPT L71921002H, Adresa: Pallati me shigjeta, Rruga e "Kavajës", Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.766/2021, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. I.1. Vlera limit e përlloritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik., në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 06-11-2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit

“E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-67760-11-05-2025, me objekt: “Verifikimi dhe testimi i sistemeve të zjarrit në impiantet përgjatë gazsjellësit TAP”, me fond limit 4.328.529 (kater milion e treqind e njezete e tete mije e peseqind e njezete e nente) lekë pa tvsh (pa TVSH), zhvilluar me datë 30-01-2026 nga autoriteti kontraktor, Albanian Gas Service Company Sh.a.

II.2. Në datën 12.12.2025, autoriteti kontraktor ka bërë vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | | |
|--|----------------|-------------|
| 1. “FIRE ” Sh.p.k | 3,318,500 Lekë | kualifikuar |
| 2. “Mbrotjtja dhe Shpetimit nga Zjarri” Sh.p.k | 3,490,000 Lekë | kualifikuar |

II.3. Në datën 09.02.2026, autoriteti ka bërë publikimin e njoftimit të fituesit paraprak për procedurën e prokurimit publik në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

II.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, “Mbrotjtja dhe Shpetimit nga Zjarri” Sh.p.k ka paraqitur ankesë me numër ankimi elektronik A/2026/6327, me datë 14.02.2026, dhe protokolluar me nr.477/2026 prot., datë 16.02.2026, pranë Komisionit të Prokurimit Publik .

II.5. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 477/1 prot., datë 16.12.2026 lidhur me pretendimet që “Mbrotjtja dhe Shpetimit nga Zjarri” Sh.p.k ku kundërshton me anë të ankesës kualifikimin e operatorit ekonomik “FIRE ” Sh.p.k

II.6 Me shkresën nr. 477/2 prot., datë 25.02.2026, Komisioni e Prokurimit Publik i është drejtuar autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë ankimues, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Me shkresën nr. 47/1 prot., datë 24.02.2026, ardhur nëpërmjet sistemit elektronik protokolluar me tonen me nr. 477/3 datë 225.02.2026, si dhe nëpërmjet postës zyrtare, protokolluar me tonën me nr.477/4 prot., datë 26.02.2026 është përcjellë nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se autoriteti kontraktor e ka pranuar pjesërisht atë :

“[...]Bazuar sa më sipër, sa është trajtuar ankesa Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës vendos ta pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ...]

II.8. Me shkresën nr. 477/5 prot., datë 26.02.2026, autoriteti kontraktor informon se ka përcjellë informacionin e kërkuar nga Komisioni e Prokurimit Publik , shkresë e cil k rdhur ne rrugë postare si dhe nëpërmjet sistemit online.

II. 9. Referuar parashikimeve të nenit 113 të “Ligjit për prokurimin publik” i ndryshuar, rezulton se nuk ka argumenta nga palët e interesuara, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të çenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit “Mbrojtja dhe Shpetimit nga Zjarri” Sh.p.k për kualifikimin e operatorit ekonomik “Fire ” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1. 2. Me shkresën nr. 47/1 prot., datë 24.02.2026, ardhur nëpërmjet sistemit elektronik protokolluar me tonen me nr. 477/3 datë 225.02.2026, si dhe nëpërmjet postës zyrtare, protokolluar me tonën me nr.477/4 prot., datë 26.02.2026 autoriteti kontraktor infomon me vendimi mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se autoriteti kontraktor e ka pranuar pjesërisht atë si në vijim :

[...] Duke qenë se oferta e OE “i-Fire” SHPK ka patur disa mangësi kualifikimi nga KVO është bërë në kundërshtim me nenin 92, pika 3 të LPP-së ku përcaktohet se:“Autoriteit enti kontraktor, në zbatim të pikë 8 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij” ligji”.

Bazuar në sa është trajtuar më sipër Komisioni i shqyrtimit të ankesës vendos te pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Mbrojtja dhe shpëtimi nga zjarri” SHPK nr.120/5, datë 14.02.2026, mc REF-67760-11 -05-2025, me objelit “Verifikimi dhe testimi i sistemeve të zjarrit në impiantet përgjatë gazsjellësit TAP” dhe fond limit prej 4.328.529 (katër milion e treqind e njëzet e tetë mijë e pesëqind e njëzet e nëntë) lekë pa tvsh.].

III.1.3. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.4. Neni 114 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se: *1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;*
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;*
- c) refuzimin e ankesës.*

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor

III.1.5. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

- i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;*
- ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.6. Nga shqyrtimi i informacionit të administruar me anë të nr. 47/1 prot., datë 24.02.2026, ardhur nëpërmjet sistemit elektronik protokolluar me tonën me nr. 477/3 datë 225.02.2026, si dhe nëpërmjet postës zyrtare, protokolluar me tonën me nr.477/4 prot., datë 26.02.2026 autoriteti kontraktor informon mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se autoriteti kontraktor e ka pranuar pjesërisht atë si në vijim :

[...] Duke qenë se oferta e OE “i-Fire” SHPK ka patur disa mangësi kualifikimi nga KVO është bërë në kundërshtim me nenin 92, pika 3 të LPP-së ku përcaktohet se: “Autoriteti enti kontraktor, në zbatim të pikës 8.4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”.

Bazuar në sa është trajtuar më sipër Komisioni i shqyrtimit të ankesës vendos të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Mbrojtja dhe shpëtimi nga zjarri” SHPK nr.120/5, datë 14.02.2026, me REF-67760-11-05-2025, me objektin “Verifikimi dhe testimi i sistemeve të zjarrit në impiantet përgjatë gazsjellësit TAP” dhe fond limit prej 4.328.529 (katër milion e treqind e njëzet e tetë mijë e pesëqind e njëzet e nëntë) lekë pa tvsh.].

Në këto kushte, duke qenë se operatori ekonomik “Fire” shpk nuk ka paraqitur argumenta sipas nenit 113 të LPP-së, bazuar në pikën 3 të nenit 115 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative për pjesën e pranuar të ankesës paraqitur nga operatori ekonomik “Mbrojtja dhe shpëtimi nga zjarri” SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik “Mbrojtja dhe shpëtimi nga zjarri” SHPK, për kualifikimin e operatorit ekonomik “Fire” shpk, Komisioni gjykon të mos i marrë në shqyrtim, referuar nenit 3, pika 6, ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” ku parashikohet “Sipas parimit të ekonomisë, efijencës dhe efektivitetit, caktimi dhe shpërndarja e përgjegjësisve, si dhe organizimi i administratës shtetërore duhet të sigurojnë efektivitetin në kryerjen e funksioneve dhe detyrave, efijencën në arritjen e objektivave të politikave të miratuara, si dhe ekonominë në përdorimin e të mirave dhe fondeve publike” si dhe gjithashtu referuar arsyesimit të bërë në pikën III.1.6 të këtij vendimi, statusi i operatorit ekonomik do të kalojë nga i kualifikuar me status i skualifikuar duke përmbushur kështu interesin e operatorit ekonomik ankimues “Mbrojtja dhe shpëtimi nga zjarri” SHPK.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për

përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë është për pjesën e pranuar të operatorit ekonomik “Mbrojtja dhe shpëtimi nga zjarri” SHPK për procedurën e në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-67760-11-05-2025, me objekt: “Verifikimi dhe testimi i sistemeve të zjarrit në impjantet përgjatë gazsjellësit TAP”, me fond limit 4.328.529 (kater milion e treqind e njetete e tete mije e peseqind e njetete e nente) lekë pa tvsh (pa TVSH), zhvilluar me datë 30-01-2026 nga autoriteti kontraktor, Albanian Gas Service Company Sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të rivlersojë ofertën e operatorit ekonomik “Fire” sh.p.k duke e skualifikuar atë sipas konstatimeve të vendimit të KSHA-së.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Mbrojtja dhe shpëtimi nga zjarri” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

